



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 196, datë 09.04.2024

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT {...}

DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË

**GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 77, DATË 20.02.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.04.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 77, datë 20.02.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me disa vendime të datës 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor *(më poshtë referuar si Këshilli)* hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 77, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.
2. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.03.2024.
3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 77, datë 20.02.2024 *(më poshtë referuar si vendimi 77/2024, kandidoi edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Shkodër.*

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit 77/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.
5. Kandidati më parë kishte aplikuar në pozicione të ngritjes në detyrë. Kandidati z. {...}, në zbatim të pikës 5 të nenit 43 dhe pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*më poshtë referuar si Ligji për Statusin*), ka njoftuar së bashku me këtë aplikim se ka hequr dorë nga kandidimi për 1(një) pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht pozicionin nr. 499 datë 21.11.2022. Për këtë kërkesë për heqje dorë nga kandidimi – Këshilli është shprehur me vendimin nr.125, datë 11.03.2024.
6. Në vijim, me vendimin nr. 140, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “*I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr... 77, ..., datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2(dy) vlerësime. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 8. Për kandidatin z. {...} - relator z. Markelian Koça; ...*”.
7. Më datë 18.03.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (*më poshtë referuar si vendimi 320/2020*), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
8. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
9. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.
10. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 19.03.2024 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

11. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër informacioni i kërkuar është përcjell nëpërmjet shkresës nr.582 prot., datë 25.03.2024, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

A. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

12. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 77/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.
13. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.
14. Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ka përvojë në seksionin civil. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015. Me dekret nr. 8768, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 9654, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
Me vendim nr. 6, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Me vendim nr. 176, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimi në pozicion e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
Me vendim nr. 136, datë 28.03.2023 *“Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”*, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.
Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

15. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nga verifikimet e kryera, rezulton se për kandidatin: “Së pari: Në lidhje me magistratin z. {...}, ai ushtron funksionet e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër prej datës 28.06.2016 (dekretimit të presidentit). Me vendimin nr. 06 datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar përkohësisht si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, duke u rikthyer përsëri pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në zbatim të vendimit nr. 176 datë 11.09.2021 të KLGJ-së për “Deklarimin e periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...}”.

Gjatë periudhës që ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka qenë pjesë e Dhomës Civile të kësaj gjykate për periudhën 13.07.2016- 28.07.2017 kur po me Urdhër të Kryetarit të Gjykatës ka kaluar pjesë e seksionit penal, duke vijuar të gjykojë ngarkesën civile deri në përfundim të saj **siç do e referojmë më poshtë me të dhëna statistikore.**

Prej datës 28.07.2017 -21.12.2018 ka qenë pjesë e seksionit penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke vijuar gjykimin e ngarkesë së marrë më përpara .

Nga data 21.12.2018 – tetor të vitit 2019 ka qenë pjesë e trupës gjyqësore që ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, çështje të kategorisë Penale dhe Civile, pasi kjo gjykatë gjatë kësaj kohe ka patur në përbërje të saj vetëm dy gjyqtarë.

Në vijim nga tetor vitit 2019 e në vijim gjyqtari {...} ka qenë pjesë e seksionit penal dhe seksionit penal për të mitur, duke marrë ngarkesë civile vetëm në raste të ezaurimit të trupave gjyqësore në përbërje të seksionit civil .

Sa më sipër e vërtetojmë me:

Urdhër i brendshëm nr. 131 datë 13.07.2016 i kryetarit të gjykatës ku gjyqtari {...} është caktuar anëtar I dhomës civile,

Urdhër nr. 26 datë 13.02.2017 I kryetarit të gjykatës ku gjyqtari {...} është caktuar anëtar i dhomës civile,

Me datë 28.07.2017 me Urdhrin nr. 100 të Kryetarit të Gjykatës, gjyqtari {...} kalon në seksionin penal duke vijuar gjykimin e çështjeve civile të cilat do i paraqesim në të dhënat statistikore më poshtë sipas viteve kalendarike.

Në përfundim nga sa u parashtrua më sipër rezulton se gjyqtari {...} ka gjykuar çështje civile si vijon:

Viti	Shkodër	Pukë
	Civile	Civile
2018	36	1
2019	0	194
2020	0	0
2021	1	0

2022	0	1
2023	0	0

Gjyqtari {...} ka gjykuar gjatë viti 2019 nga muajin Janar – Tetor 2019; Në 2021 ka gjykuar në një afat 3 mujor çështje civile, dhe i deleguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë sa i përket përvojës së tij në fushën e drejtësisë Civile. Ndërkohë që ai ka gjykuar gjithashtu edhe në fushën e drejtësisë penale.

Në përfundim në lidhje me gjyqtarin {...} ju përcjellim materialin si vijon:

1. Të dhënat statistikore të këtij gjyqtari Gjykata Shkodër dhe Pukë ;
 2. Urdhër i brendshëm nr. 131 datë 13.07.2016 (Për një ndryshim në urdhrin e brendshëm nr. 69 datë 26.04.2016, ku gjyqtari {...} është caktuar pjesë e **dhomës civile**);
 3. Urdhër i brendshëm nr. 26 datë 13.02.2017 “Mbi ndryshimin e urdhrin të brendshëm nr. 178 datë 31.12.2015 ku gjyqtari {...} është caktuar pjesë e **dhomës civile**);
 4. Urdhër i brendshëm nr. 100 datë 28.07.2017, “Mbi ndryshimin e urdhrin të brendshëm nr. 26 datë 13.02.2017 ku gjyqtari {...} është caktuar pjesë e **dhomës civile**);
 5. Procesverbal i nxjerrë nga sistemi për gjykimin e çështjes në Gjykatën Pukë viti 2022, si dhe vendimi dhe informacion mbi këtë çështje nxjerrë nga sistemi.
16. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 77, datë 20.02.2024, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike”.

B. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

17. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit 77/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka në fuqi një masë disiplinore.*”
18. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 01.03.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.
19. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.
20. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

C. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

21. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit 77/2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.
22. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 01.03.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.
23. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale të kandidatit {...}, i cili aplikon për pozicionin një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, dhe situatës kur bashkëjetuesja, magjistratja Oltjona Goxha, ushtron funksionin e gjyqtarit në seksionin penal të Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Tiranë, Komisioni merr në konsideratë këto kriterë: i) *mënyrën sesi ushtrojnë funksionet gjyqtarët në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*. Funksionet e gjyqtarëve janë totalisht të dallueshme dhe pa interferuar tek puna e detyrat e njëri-tjetrit; gjyqtarët e seksionit civil gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si gjyqtarë në Gjykatën e Tiranës, nuk kanë lidhje, ndikim, mbivendosje, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo në mënyrë të tërthortë, me funksionet që ushtrojnë gjyqtarët e seksionit penal në Gjykatën e Tiranës; ii) Në Gjykatën e Tiranës, në raport me gjykatat e tjera të Republikës, gjyqtarët e seksionit civil ushtrojnë funksionin në ambiente/godina të ndryshme me atë të seksionit penal; iii) numrin relativisht të lartë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në këtë gjykatë;
24. Pra referuar mënyrës së funksionimit, referuar numrit relativisht të lartë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Tiranës në raport me gjyqtarët e gjykatave të tjera të rretheve gjyqësore, referuar selive sepse i referohemi selive duke iu referuar kriterit ligjor,

ambienteve, vlerësohet se në këtë rast nuk shkelet parimi i papajtueshmërisë ambientale parashikuar nga neni 8 i ligjit “Për statusin”.

25. Gjatë verifikimit, nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
26. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

27. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit të Këshillit nr. 77 datë 20.02.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të z. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.
28. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 77 datë 20.02.2024.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 77, datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Markelian Koça,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 77 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR